



Datë: 16.04.2025

Numër Protokolli: 2875/2025

A.nr.41/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari -kryetare, Ardita Haxhnikaj - Demi dhe Eshref Shabani -anëtare, me Ylber Fetahaj- në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.41/2025 të datës 09.01.2025 të parashtruar nga D.K; Xh.R; A.C; A.V; S.I; F.K; G.G; I.V; I.M; L.M; L.K; N.Q; B.L; Sh.A; V.K; V.R; S.B; E.L; B.M; D.D; H.N; S.A; Sh.F; F.Sh; A.S; E.L; A.G ; N.T; I.H; P.B; S.S; G.G dhe A.K të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Av. Vigan Rugova nga Prishtina kundër organit të punësimit/Agjencisë e Shërbimit të Navigacionit Ajrore, në çështje juridike “*Kompensim material*”, në mbështetje të nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 16.04.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr 41/2025, e datës 09.01.2025, e parashtruar nga ankuesit D.K, Xh.R, A.C, A.V, S.I, F.K, G.G, I.V, I.M, L.M, L.K, N.Q, B.L, Sh.A, V.R, E.L, H.N, A.G, N.T, S.S, G.G dhe A.K,

II. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **shpallet jo kompetent** për të shqyrtuar dhe vendosur për ankesën me numër A.nr.41/20245 të datës 09.01.2025, të parashtruar nga ankuesit, S.B, B.M, D.D, S.A, Sh.F, F.Sh, A.S, E.L, P.B, I.H dhe V.K.

III. Pala ankuese sipas pikës II të dispozitivit të këtij vendimi udhëzohet mbi drejtën e inicimit të konfliktit administrativ në gjykatën kompetente.

A r s y e t i m

Ankuesit si në preambulë të vendimit, me datë 09.01.2025, përmes përfaqësuesve të autorizuar, Av. Vigan Rugova nga Prishtina, kanë parashtruar ankesë me numër protokolli 68/2025 të regjistruar nën shenjen A.nr.41/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për njohën e drejtës se kompensimit në të ardhurat personale dhe kontributet tjera ne mënyre retroaktivë nga data 01.03.2013 deri ne pagesën definitivë sipas kontratës së punës ndërsa tani e tutje tu paguhen te ardhurat e plota dhe njëkohësisht të Anulohet vendimi i KA-Nr. 0006/2024 i datës 26.12.2024 i Komisionit të Ankesave i ASHNA.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 27.01.2025 ka dërguar

kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencisë e Shërbimit të Navigacionit Ajrore, ndërsa më datë 03.02.2025, ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) ka administruar këto prova: Ankesën Ame Numër Prot. 68/2025 të datës 09.01.2025, Kërkesën e datës 08.11.2024; ankesën për komisione ankesave ne ASHN te datës 09.12.2024; Vendimin e datës 30.12.2024 të Komisionit për Ankesa ne ASHNA; Vendimin e KPMSHCK me numër A. nr. 821/2024 te datës 29.07.2024; Përgjigjen ne ankesa te datës 03.02.2025 nga ASHNA; Akt Emërimin e datës 08.03.2019 te D.K; Akt Emërimin e datës 01.04.2017 te XH.R; Akt Emërimin e dt. 01.04.2017 te A.C; Vendimin e datës 28.02.2022;Akt Emërimin e dt. 01.04.2017 te A.V; Akt Emërimin e datës 01.04.2017 S.I; Akt Emërimin e dt. 01.04.2017 te F.K; Akt Emërimin e dt. 03.04.2017 G.G; Akt Emërimin e datës 01.04.2017 te I.V; Akt Emërimin e dt. 01.04.2017 te I.M; Akt Emërimin e dt. 01.07.2017 te L.M; Vendimin e dt.06.11.2024; Akt Emërimin e datës 01.04.2017 te L.K; Akt Emërimin e datës 15.08.20217 te N.Q; ndryshim plotësim e Akt Emërimit te datës 09.09.2020 për B.N; Vendimin e datës 13.05.2022; Akt Emërimin e datës 03.02.2017 për Sh.A; Akt Emërimin e datës 03.04.2017 për V.K’ Vendimin e datës 01.04.2022; Akt Emërimin e datës 03.04.2017 për V.R; Akt Emërimin e datës 19.04.2017 për S.B; Akt Emërimin e datës 03.04.2017’; Vendimin e datës 04.11.2024; Akt Emërimin e datës 19.04.2017 te B.M; Akt Emërimin e datës 19.04.2017 për D.D; Vendimin e datës 06.12.2019; Akt Emërimin e datës 19.04.2017 për H.N; Akt Emërimin e datës 19.04.2017 për S.A; Akt Emërimin e datës 19.04.2017 për SH.F; Akt Emërimin e datës 19.04.2017 për F.Sh; Akt Emërimin e datës 19.04.2017 për A.S; Akt Emërimin e datës 19.04.20217 për E.L; Akt Emërimin e datës 03.04.2017 për A.G; Akt Emërimin e datës 19.04.2017 për N.T; Akt Emërimin e datës 19.04.2027 për I.H; Akt Emërimin e datës 19.04.2017 për P.B; Akt Emërimin e datës 03.02.2017 për S.S; Akt Emërimin e datës 03.04.2017 për G.G; Akt Emërimin e datës 07.06.218 për A.K; Kërkesën e datës 22.01.2024; Përgjigjen ne kërkesën te datës 07.02.2024; Kartelat e nëpunësit për listën e pagave; Kërkesën datës 06.12.2024 për kompensimin e ne dallimin e pagave; Vendimin e datës 30.12.2024 me numër 006/2024 Aprovimin për nivelizimin e pagës i datës 06.03.2013; Aprovimin e datës 04.03.2013;

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa e ankuesve si në pikën I të dispozitivit, **është e pabazuar, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesi D.K sipas Akt Emërimit të datës 08.03.2019 mban pozitën “Teknik Udhëheqës i Ndërrimit KOM&MET”, ankuesi Xh.R sipas AKT Emërimit të datës 05.04.2017 mban pozitën “Teknik i KOM&MET”, ankuesi A.C SIPAS Akt Emërimit të datës 03.04.2017 mban pozitën “Teknik i Sistemit të Navigimit”, ankuesi A.V sipas Akt Emërimit të datës 03.04.2017 mban pozitën “Teknik i Sistemit të Navigimit”, ankuesi S.I sipas Akt Emërimit të datës 03.04.107 mban pozitën “Specialist i Sistemit të Procedimit të të Dhënave”, ankuesi F.K sipas Akt Emërimit të datës 03.04.2017 mban pozitën “Teknik i Sistemit të Survejimit”, ankuesi G.G sipas Akt Emërimit të datës 03.04.2017 mban pozitën “Teknik i Sistemit të Survejimit”, ankuesi I.V sipas Akt Emërimit të datës 03.04.2017 mban pozitën “Teknik i Sistemit të Survejimit”, ankuesi I.M sipas Akt Emërimit të datës 03.04.2017 mban pozitën “Specialist i Sistemit të Komunikimit dhe Pajisjeve të Meteorologjisë”, ankuesi L.M sipas Akt Emërimit të datës 07.06.2018 mban pozitën “Specialist i Sistemeve të Tensionit të Lartë dhe Klimave”, ankuesi L.K sipas Akt Emërimit të datës 03.04.2017 mban pozitën “Teknik KOM&MET”, ankuesi N.Q sipas Akt Emërimit të datës 15.08.2017 mban pozitën “Teknik KOM&MET”, ankuesi B.L sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të Aktit të Emërimit të datës 09.09.2020 mban pozitën “Specialist i Divizionit të Navigimit”, ankuesi Sh.A sipas Akt Emërimit të datës 03.02.2017 mban pozitën “Teknik Kom&met”, ankuesi V.R sipas Akt Emërimit të datës 03.04.2017 mban pozitën “Teknik i Sistemit të Survejimit”, ankuesi E.Ll sipas Akt Emërimit të datës 03.04.2017 mban pozitën “Specialist i Sistemit të Navigimit”, ankuesi H.N sipas Akt Emërimit të datës

19.04.2017 mban pozitën “Zyrtar për Siguri dhe Shëndet në Punë”, ankuesi A.G sipas Akt Emërimit të datës 03.04.2017 mban pozitën “Teknik i Sistemit të Navigimit”, ankuesit N.T sipas Akt Emërimit të datës 19.04.2017 mban pozitën “Zyrtar i Arkivit”, ankuesi S.S sipas Akt Emërimit të datës 03.04.2017 mban pozitën “Udhëheqës i Divizionit të Komunikimi Kom&Met”, ankuesi G.G sipas Akt Emërimit të datës 03.04.2017 mban pozitën “Udhëheqës i Divizionit të Teknologjisë Informative”, ankuesi A.H sipas Akt Emërimit të datës 07.06.2018 mban pozitën “Udhëheqës i Divizionit të Survejimit” të gjithë të punësuar në Agjencinë e Shërbimit të Navigacionit Ajror.

Tutje sipas shkresave të lëndës rezulton se ankuesit përmes përfaqësuesit të autorizuar, Avokatit Vigan Rogova, me datë 08.11.2024 i janë drejtuar me kërkesë organit të punësimit, gjegjësisht Drejtorit të Agjencisë së Shërbimit të Navigacionit Ajrore, duke kërkuar kompensimin e dallimit në pagë dhe kontributet pensionale si rezultati i Vendimit të Bordit të Drejtorëve të datës 01.03.2013 për nivelimin e pagave dhe atë në mënyrë retroaktive pjesën e të ardhurave nga data 01.03.2013 deri në janar 2024, ndërsa kontributet pensionale nga muaji dhjetor 2013 deri në muajin dhjetor 2015, pasi që nuk u janë paguar kontributet pensionale, ndërsa më datë 06.12.2024 i janë drejtuar me ankesë Komisionit për Ankesa të Agjencisë e Shërbimit të Navigacionit Ajror. Komisioni për Ankesa të Agjencisë e Shërbimit të Navigacionit Ajror, më datë 30.12.2024 ka nxjerr Vendim KA-Nr.006/2024 me të cilin për ankuesit S.B, B.M, D.D, S.A, Sh.F, F.Sh, A.S, E.L, P.B dhe I.H ka refuzuar ankesën e datës 06.12.2024 si te pabazuar, ndërsa për ankuesit D.K, Xh.R, A.C, A.V, S.I, F.K, G.G, I.V, I.M, L.M, L.K, N.Q, B.L, Sh.A, V.R, E.L, H.N, A.G, N.T, S.S, G.G dhe A.K, është shpall jo kompetent për të shqyrtuar ankesën e tyre me arsyetimin se nuk kanë kompetencë të shqyrtoj ankesat e nëpunësve të shërbimit civil.

Ankuesit në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendojnë se organi i punësimit nuk ka bërë kompensimin e të ardhurave personale sipas emailit të datës 06.03.2013 të Kryeshefit Ekzekutiv të ASHNA pas aprovimit të nivelimit të pagave nga Bordi i Drejtorëve i ASHNA, duke kërkuar që ankesa të aprovohet në tërësi ashtu që të ju paguhet dallimi në të ardhurat personale dhe kontributet tjera në mënyrë retroaktive nga data 01.03.2013 deri në pagesën definitive sipas kontratave të punës, ndërsa tani e tutje tu paguhet të ardhurat e plota dhe njëkohësisht të anulohet vendimi i KA Nr.006/2024 i datës 26.12.2024 i Komisionit të Ankesave i ASHNA.

Lidhur me pretendimet ankimore të ankuesve si në pikën I të dispozitivit, konstaton se referuar kërkesës së ankuesve e cila ka të bëjë me kompensimin e të ardhurave personale sipas emailit të datës 01.03.2013 të Kryeshefit Ekzekutiv të ASHNA pas aprovimit të nivelizimit të pagave nga Bordi i Drejtorëve, Kolegji i Këshillit, marrë për bazë natyrën e çështjes në procedurë ankimore ju referua dispozitave të nenit 2 paragrafi 1 dhe 2, ndërlidhur me nenin 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, ku përcaktohet se: “1. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për të punësuarit dhe punëdhënësit e sektorit privat dhe publik në Republikën e Kosovës. 2. **Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për të punësuarit dhe punëdhënësit, punësimi i të cilëve rregullohet me ligj të veçantë, nëse ligji i veçantë nuk parashikon zgjidhje për çështje të caktuara nga marrëdhënia e punës;... neni 87 : Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës**” dhe si rrjedhojë erdhi në përfundimin se dispozitat e nenit 87, të ligjit përkatës të punës gjejnë zbatim edhe në trajtimin e kësaj çështje administrative.

Andaj, referuar përcaktimeve ligjore si më sipër, Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës, mori për bazë edhe dispozitat ligjore të cilët rregullojnë çështjen e ekzekutueshmërisë së akteve administrative, gjegjësisht dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 144 [Ekzekutueshmëria e aktit] ku përcaktohet se: 1. *Një akt administrativ do të bëhet i ekzekutueshëm me: 1.1. skadimin e afatit për ankesën kundër tij, nëse një ankesë e tillë nuk është parashtruar; 1.2. njoftimin e palës, me aktin, kur*

sipas ligjit, nuk lejohet ankesa; 1.3. njoftimin e palës me aktin, kur, sipas ligjit, ankesa nuk ka efekt pezullues 1.4. njoftimin e palës me aktin e ndalimit të efektit pezullues të ankesës, në pajtim me paragrafin 3 të nenit 130 të këtij Ligji, apo 1.5. njoftimin e palës për refuzimin e ankesës. 2. Akti i zgjidhjes së ankesës që ndryshon një akt administrativ të ankimuar, bëhet i ekzekutueshëm me njoftimin e palës. **3. Akti administrativ nuk mund të ekzekutohet nëse kanë kaluar pesë (5) vite nga koha kur akti administrativ është bërë i ekzekutueshëm dhe nuk është ndërmarrë asnjë veprim ekzekutimi, apo kanë kaluar 3 (tre) vite nga veprimi i fundit për ekzekutimin.** Rrjedhimisht, duke u bazuar në dispozitat e nenit 144 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit ka gjetur se Vendimi i Bordit të Drejtoreve të Aeroportit të cilin ka hyrë në fuqi nga data 01.3.2013, dhe meqenëse nga kjo kohë deri në kërkesën e palëve kanë kaluar më shumë se pesë (5) vite, atëherë sipas dispozitave të cekura si më lartë, Kolegji i Këshillit vlerëson se kërkesa e ankuesve është e pa realizueshme ngase palët nuk kanë ndërmarr veprime lidhur me ekzekutimin/mosekzekutimin e aktit administrativ, brenda afateve të përcaktuara me dispozitat e legjislacionit përkatës për procedurën administrative, në rrethanat e rastit konkret ka arritur koha e parashkrimit absolut dhe se nën rrethanat e mësipërme, Vendimi i datës 01.03.2013 nuk mund të ekzekutohet në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 144 paragrafi 3 ku përcaktohet se: **3. Akti administrativ nuk mund të ekzekutohet nëse kanë kaluar pesë (5) vite nga koha kur akti administrativ është bërë i ekzekutueshëm dhe nuk është ndërmarrë asnjë veprim ekzekutimi, apo kanë kaluar 3 (tre) vite nga veprimi i fundit për ekzekutimin.**

Përkitazi me këtë Kolegji i Këshillit, konstaton faktin se meqë ankuesit kanë statusin e nëpunësit të shërbimit civil atëherë i vetmi organ që shqyrton ankesat e tyre ndaj veprimit apo mos veprimit të organit të punësimit është Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës siç parashihet me nenin 27 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrat e Publikë, kështu që Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka kompetencë të shqyrtoj ligjshmërinë e vendimeve të Komisionit të Ankesave.

Kështu që thënë si më sipër e duke u bazuar në dispozitat e nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenit 132 paragrafi 2 ndërlidhur me nenin 144 paragrafi 3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në pikën I të dispozitivit.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës **nuk është kompetent për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesit si në pikën II të dispozitivit, sepse:**

Kolegji i Këshillit, nga analizimi i shkresave të lëndës, ka gjatuar se ankuesi S.B sipas Akt Emërimit të datës 19.04.2017 mban pozitën e punës “Mbikëqyrës i Ndërrimit në Sigurim”, ankuesi B.M sipas Akt Emërimit të datës 19.04.2017 mban pozitën “Personel i Sigurimit”, ankuesi D.B sipas Akt Emërimit të datës 19.04.2017 mban pozitën “Personel i Sigurimit” ndërsa të njëjtit i është ndërprerë marrëdhënia e punës sipas Vendimit me Nr.97/19 të datës 06.12.2019, ankuesi S.A sipas Akt Emërimit të datës 19.04.2017 mban pozitën “Mbikëqyrës i Ndërrimit në Sigurim”, ankuesi Sh.F sipas Akt Emërimit të datës 19.04.2017 mban pozitën “Mbikëqyrës i Ndërrimit në Sigurim”, aneksi F.Sh sipas Akt Emërimit të datës 19.04.2017 mban pozitën “Personel i Sigurimit”, ankues A.S sipas Akt Emërimit të datës 19.04.2017 mban pozitën “Personel i Radioskopit”, ankuesi E.L sipas Akt Emërimit të datës 19.04.2017 mban pozitën “Personel i Sigurimit”, ankuesi P.B sipas Akt Emërimit të datës 19.04.2017 mban pozitën “Mbikëqyrës i Ndërrimit në Sigurim”, dhe ankuesi I.H sipas Akt Emërimit të datës 19.04.2027, mban pozitën

“Udhëheqës i Divizionit të Sigurimit”, të gjithë të punësuar në Agjencinë e Shërbimit të Navigacionit Ajror.

Kolegji i Këshillit duke ju referuar pozitave të ankuesve të cekur si më lartë, konstaton lidhur me statusin e pozitës së tyre, ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht neni 5 paragrafi 5 përcakton se: *5. Nëpunësja/i teknik dhe mbështetës është zyrtarja/i publik që kryen veprimtari ndihmëse të mirëmbajtjes, të ruajtjes, të vozitjes dhe veprimtari të ngjashme në institucionet publike*, po ashtu lidhur me nëpunësit teknik dhe mbështetës, Kolegji ju referua neni 95 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, i cili parasheh: *“1. Punëdhënës në marrëdhënien e punës të nëpunëses/it teknik dhe mbështetës është institucioni përkatës, përmes udhëheqëses/it më të lartë administrativ të institucionit. 2. Përveç sa parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë pjesë të ligjit, marrëdhënia e punës ndërmjet institucionit dhe nëpunëses/it teknik dhe mbështetës rregullohet me legjislacionin e punës”*, andaj Kolegji i Këshillit, referuar dispozitave të cekura ma lartë, konstaton pozita e ankuesve hyn në kuadër të nëpunësit teknik dhe mbështetës.

Kolegji i Këshillit, lidhur me statusin e pozitës së ankuesve të cekur si më lartë, ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht neni 5 paragrafi 5 i cili përcakton se: *5. Nëpunësja/i teknik dhe mbështetës është zyrtarja/i publik që kryen veprimtari ndihmëse të mirëmbajtjes, të ruajtjes, të vozitjes dhe veprimtari të ngjashme në institucionet publike*”, po ashtu ndërlidhur me marrëdhënien e punës për nëpunësit teknik dhe mbështetës, Kolegji i Këshillit ju referua neni 95 Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, i cili parasheh se: *1. Punëdhënës në marrëdhënien e punës të nëpunëses/it teknik dhe mbështetës është institucioni përkatës, përmes udhëheqëses/it më të lartë administrativ të institucionit. 2. Përveç sa parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë pjesë të ligjit, marrëdhënia e punës ndërmjet institucionit dhe nëpunëses/it teknik dhe mbështetës rregullohet me legjislacionin e punës.”*, dhe për rrjedhoi konstatoi se të lartshënuarit për shkak të pozitave të tyre të punës *Zyrtar për Telefoni* të cilat i mbajnë sipas Kontratave të punës për kohë të pacaktuar, nuk kanë statusin e Nëpunësit të Shërbimit Civil, mirëpo të Nëpunësit Teknik dhe Mbështetës, ndërsa marrëdhënia e tyre e punës i nënshtrohet dispozitave të ligjit të punës dhe legjislacionit të veçantë të fushës.

Lidhur me procedurën e ushtrimit të mjeteve juridike në mbrojtje të drejtave nga marrëdhënia e punës, Kolegji i Këshillit në mbështetje të neni 27 paragrafi 1, të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, si dhe neni 78 dhe 79 të Ligjit 03/L-212 të Punës, rithekson faktin se nëpunësit teknik dhe mbështetës fillimisht duhet të ankohen tek punëdhënësi dhe më pas mund të fillojnë kontestin administrativ në gjykatën kompetente.

Meqenëse nga shkresat e lëndës rezulton se pozita e ankuesit është pozitë e nëpunësit teknik dhe mbështetës dhe nuk ka statusin e nëpunësit të shërbimit civil, duke u bazuar në dispozitat e neni 6 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent që të shqyrtoj dhe të merr vendime vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil të Kosovës, kështu që mbi bazë të këtyre pikëpamjeve Kolegji i Këshillit, vendosi që të shpallë veten jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga ankuesit si në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

Po ashtu Kolegji i Këshillit, konstaton se ankuesi V.K i cili sipas Akt Emërimit të datës 03.04.2017 ka mbajtur pozitën “Teknik i Divizionit të Teknologjisë Informative”, por që të njëjtit i është ndërprerë

marrëdhënia e punës nga data 01.04.2022 sipas Vendimit me Nr. 17/22 të Drejtorit të ASHNA-s, rrjedhimisht nga kjo datë ankuesi V. K nuk e ka statusin e nëpunësit të shërbimit civil.

Marrë parasysh konstatimin si më lartë se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesve si në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi, dhe meqenëse nga shkresat e lëndës rezulton se ankuesit kanë shfrytëzuar mjetet juridike në procedurë administrative pranë organit punëdhënës, Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në nenin 75 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, udhëzon palën ankuese se kundër Vendimit KA-Nr. 006/2024 të datës 30.12.2024 të Komisionit të Ankesave të ASHNA mund të iniciojnë konfliktin administrativ në gjykatën kompetente.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë Juridike: *Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.41/2025

Ylber Fetahaj

Procesmbajtës

Malsore Gashi Bajraktari

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesve, Av. Vigan Rogova;
- Drejtorit të ASHNA-së
- Udhëheqësit të Personelit në ASHNA;
- Arkivit të KPMSHCK-së.